Salih Kabashi

Sami Frashëri thoshte se bilbilin e mbajnë në kafaz për zërin e bukur që ka, filin e vrasin për dhëmbët e eshtrat e tij qelibar, ndërsa e mbajnë në burg njeriun për mençurinë dhe mendjen e shpirtin e tij të ndritur.

Të ditur e të ndritur janë burrat nga lista e mëposhtme. Këta askujt asnjëherë nuk i kanë bërë asnjë të keqe. Megjithatë regjimi dhe qeveria marionetë e Kosovës këta i ka ndryrë në burg!

Shteti në të gjitha linjat e tij i dështuar i Kosovës, pasi me vite të tëra toleroi dhe për më tepër edhe inkurajoi dhe investoi në terrorizmin verbal kundër ylemasë kosovare, tash e gjeti rastin, më mirë të thuhet e mori sinjalin që të vërsulet brutalisht kundër prijësve të xhamive më të mëdha të vendit. Arbitraritet e dhunë të këtillë nuk mban mend historia e Kosovës as ajo shqiptare.

Dua të solidarizohem me këta burra.

Personalisht nuk njoh asnjërin prej tyre. Nuk jam falur në asnjërën nga xhamitë e tyre.

Solidariteti im me këta dijetarë nuk është i karakterit fetar.

Është ndërgjegjja ime që më thotë se këta po ndiqen e po persekutohen për gjerat që janë në pajtim absolut me kushtetutën, ligjet kombëtare dhe me kartat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Kushtetuta, ligjet, konventat ndërkombëtare për lirinë e shprehjes, për lirinë e besimit, për të drejtën e shfaqjes lirisht të opinioneve, me burgosjen e kësaj ylemaje, janë shkelur barbarisht e arbitrarisht si nga prokuroria poashtu edhe nga gjyqësia e Kosovës, të cilat, tashmë dihet botërisht se veprojnë të teledirigjuara.

Këto shkelje do të kenë pasoja të paparashikueshme për stabilitetin ashtu e kështu të luhatur të Republikës, të cilën e gangrenizon me vite të tëra korrupsioni e vjedhjet nga personat e niveleve më të larta të të gjitha pushteteve.

Besoj në pafajësinë e këtyre burrave. E mbroj të drejtën e tyre për liri dhe bëj thirrje të zëshme që sa më parê t'u rikthehet ajo.

Njësoj besoj se qeveria në ikje (bashkë me korin e kukuvajkave mediatike), me këto burgosje të palejueshme e të pajustifikueshme, kanë bërë shkeljen më të rëndë të mundshme të drejtave dhe lirive të njeriut bashkë me vetë ligjet e Kushtetutën.

Phoca PDF

Shefqet Krasniqin, Bedri Robajn, Idriz Bilibanin, Enes Gogën, Mazllam Mazllamin, Ekrem Avdiun, Enis Ramën, Fuad Ramiqin, Alban Malsiun, Dardan Gjukën, Eroll Nesimin, Leonard Rulin, Sabahudin Selimin dhe Trim Ademin i konsideroj të burgosurit e vetëm të ndërgjegjes në Evropë.

Phoca PDF